



Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 3.6 dhe nenit 21, paragrafi 1, në kuptim të nenit 47, paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i shpallur në Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/2016 të datës 14 Janar 2016, Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 11/2019 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E, RREGULLORES NR. 03/2016,
RREGULLORES NR. 04/2016, RREGULLORES NR. 05/2016, RREGULLORES NR. 06/2016 DHE
RREGULLORES NR. 07/2016**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim harmonizimin e shprehjeve të caktuara, të përdorura në aktet nënligjore të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit dhe ofruesve të shërbimeve të ujit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet për aktet nënligjore në vijim:

- 1.1. Rregulloren Nr.03/2016 për Kartën e Konsumatorit të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- 1.2. Rregulloren Nr. 04/2016 për Inspektimin e Përbushjes së Obligimeve Rregullatore nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- 1.3. Rregulloren Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- 1.4. Rregulloren Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë,
- 1.5. Rregullore Nr.07/2016 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.

Neni 3

Ndryshim plotësimi i akteve nënligjore të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit

1. Shprehjet e përdorura në aktet nënligjore të cekura në Nenin 2 të kësaj Rregullore, riformulohen me tekstin si në vijim:
 - 1.1. **Zona e shërbimit** - zona e shërbimit e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës
 - 1.2. **Ofrues i shërbimeve** - çdo person juridik i regjistruar që ka aktivitet primar, ofrimin e shërbimeve të ujit;
 - 1.3. **Faturë** - dokumenti i cili i dërgohet konsumatorit nga ofruesi i shërbimeve për të paguar detyrimet për shërbimet e ofruara;
 - 1.4. **Komisioni Këshillues i Konsumatorëve**-secilën herë që përmendet në aktet nënligjore të Autoritetit “**Komisioni Këshillues i Konsumatorëve**”, zëvendësohet me tekstin si në vijim: “**Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve**” i cili është themeluar dhe vepron në kuadër të Autoritetit;
 - 1.5. **Ujëmatës** - çdo aparat apo pajisje i cili përdoret nga ofruesi i shërbimeve për të matur sasinë e ujit të përpunuar dhe konsumuar.

Neni 4

Dispozitat kalimtare

Me këtë Rregullore obligohen të gjithë ofruesit e shërbimeve të bëjnë ndryshim plotësimin e rregulloreve përkatëse, për të harmonizuar shprehjet e përdorura në këtë Rregullore.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.

Datë 28.10.2019

Prishtinë

Drejtori i ARRU

Raif PRETENI